



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

Prot. 452

Tiranë, 17.12.2018

Lënda: Kërkesë për mbledhjen e Asamblesë

Për: Këshillin Ekzekutiv të Akademisë së Shkencave

Të nderuar kolegë,

- Duke qenë se prej muajit shtator 2017 postet e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit të Akademisë së Shkencave janë vakant, për shkak të dorëheqjeve;

- Duke qenë se këto dorëheqje u dhanë për t'i hapur rrugë reformës për reformimin e Akademisë së Shkencave;

- Duke qenë se reforma tani është në rrugën e duhur, siç është konfirmuar nga vetë z. Kryeministër para asamblesë së Akademisë së Shkencave më datën 20 shtator 2018 (shih <http://akad.gov.al/ash/ecuria-e-reformes?id=412>);

- Duke konstatuar se mandati i të vetmit anëtar të Kryesisë dhe njëherësh të vetmit funksionar me fuqi juridike si autoritet i Akademisë së Shkencave në drejtimin e brendshëm e në marrëdhëniet ndërinstitucionale, Sekretarit Shkencor, përfundon në mbarim të muajit shkurt të vitit 2019, e në çdo rast, me ligjin aktual ose me ligjin e ri që pritet të miratohet, zgjedhjet për Kryesinë duhet të mbahen brenda muajit shkurt 2019;

Me të drejtën që buron prej ligjit nr. 9655, datë 11.12.2006 *Për Akademinë e Shkencave*, i ndryshuar; referuar nenit 11, si dhe neneve 14, 16, 17, 19 të Statutit të Akademisë së Shkencave, ne, akademikët nënshkrues të kësaj letre, kërkojmë thirrjen e mbledhjes së zakonshme të Asamblesë, brenda datës 10 janar 2019, me rend dite:

1. Shpalljen e datës së zgjedhjeve të reja të Kryesisë, sipas nenit 17 të Statutit të Akademisë së Shkencave.

2. Ngritjen e komisionit zgjedhor të përbërë nga akademikë të cilët do të administrojnë procesin e shpalljes, kritereve, paraqitjes së platformave dhe të votimit të kandidatëve/teve.

Nënshkruar:

Floran Vito, fuqij Gudar Beqori, Romay
Petraq Petro, Seko, Nohi Frasheri
KOSTA BARYABA, Jani Varogli
Musafer Korkuti, Bazdri Golemi, Ibrahim Inan
Anesh Kordeli, Kordeli, Dimitër Haxhiu, Haxhiu